



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.10.9-2014-06

GRANTET E BUJQËSISË NË KOMUNËN E FUSHË KOSOVËS
PËR VITIN 2014

Auditimi jo i detyrueshëm

Prishtinë, Dhjetor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Artan Venhari është duke ushtruar detyrën e kreut të ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar.

Misioni ynë është “që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike”. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike dhe do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t’i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditimet e performancës kryhen për të vlerësuar nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të duhur, kost-efektive dhe efikase dhe nëse sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre janë funksionale.

UD i Auditorit të Përgjithshëm Artan Venhari ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit të performancës për “Grantet e bujqësisë në Komunën e Fushë Kosovës” i cili njëkohësisht ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti i lëshuar është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtoreshës Myrvete Gashi, i mbështetur nga Alban Shatri (Udhëheqës i ekipit).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive.....	i
1 Hyrje	1
2 Përshkrimi i procesit të granteve në Fushë Kosovë.....	4
3 Të gjeturat e auditimit.....	6
4 Konkluzionet	13
5 Rekomandimet	14
Shtojca I - Përkufizimi i kriterëve SMART	15

Lista e shkurtesave

DBZHR	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
SMART	Specifike, Të Matshme, Të arritshme , Reale, Të përkufizuara në kohë
Ha	Hektarë

Përmbledhje ekzekutive

Subvencionet dhe grantet janë instrumentet kryesore që aplikon Komuna e Fushë Kosovës për arritjen e objektivave zhvillimore në sektorin e bujqësisë, prandaj administrimi i drejtë i tyre është i një rëndësie të veçantë.

Raporti i auditimit trajton rezultatet e arritura nga Komuna e Fushë Kosovës përmes dhënies së granteve në këtë sektor, duke vlerësuar nëse komuna ka vendosur objektiva të qarta dhe në përputhje me synimet strategjike, procesin e menaxhimit të granteve, monitorimit dhe raportimit të rezultateve të pritura.

Konkluzionet

Ne kemi konstatuar se objektivat e vendosura në planin operativ 2014 nuk janë mjaft qartë të definuara dhe nuk kanë ndërlidhje të mjaftueshme me planet strategjike. Rezultatet përfundimtare të projekteve nuk janë parashikuar, mungon konsistenca në mes projekteve të planifikuara dhe objektivave të parashtruara. Rreth qartësisë së objektivave mungojnë: përcaktimi i komponentëve teknike dhe organizative, identifikimi i rezultateve të pritura dhe nuk është siguruar baza për monitorim dhe vlerësim të rezultateve.

Janë vërejtur mangësi edhe në procesin e menaxhimit të granteve. Informimi i fermerëve nuk ishte mjaft cilësor, kjo për shkak se kriteret e vendosura në konkurse nuk specifikojnë qartë grupin e synuar të fermerëve që do jenë përfitues potencial dhe metodat e informimit nuk kanë dhënë rezultate të kënaqshme.

Sistemi i monitorimit të granteve nuk ishte funksional ashtu siç pritej. Edhe pse bëhen inspektime të rastësishme (jo të strukturuar) në teren, raportimit i rezultateve nuk është i cilësisë së duhur. Kjo ka ndikuar që mekanizmi për kontrollin e progresit kundrejt planeve dhe vlerësimi i efekteve të mos funksionojë. Rrjedhimisht efektet e projekteve nuk janë plotësisht të qarta.

Në mungesë të raporteve cilësore të monitorimit dhe në mungesë të raporteve të vlerësimit, nuk ka informacion rreth rezultateve të arritura përmes granteve të dhëna. Kjo gjendje mund të shpije deri tek shpenzimi i parasë në mënyrë jo efikase dhe jo efektive.

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës të siguroi që :

- Vendosja e objektivave në planet operative të bëhet sipas kriterëve SMART¹ dhe në përputhje me objektivat strategjike.
- Të aplikojë metoda më efektive të informimit të grupit të synuar të fermerëve dhe në konkurse për grante të vendosen kriteret specifikë që fokusohen vetëm në grupin e synuar të fermerëve.

¹ Kriteret SMART janë të paraqitura në Shtojcën I

- Të dizajnohet dhe vendoset një sistem përmes së cilit do të monitorohen, raportohen dhe vlerësohen rezultatet nga grantet, dhe
- Të hartojë informata të besueshme, relevante dhe në kohë lidhur me progresin drejt arritjes së objektivave. Kjo do të forconte llogaridhënien e brendshme dhe të jashtme për burimet e përdorura dhe për rezultatet e arritura.

Komuna e Fushë Kosovës, përkatësisht Departamenti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është pajtuar me të gjitha të gjeturat dhe konkluzionet tona, dhe janë zotuar se do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Vlerësohet se 60% e popullsisë së Kosovës jeton në zonat rurale. Sektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e mundësive të punësimit dhe në krijimin e të ardhurave për banorët të cilët jetojnë në këto zona. Kontributi i sektorit të bujqësisë në Bruto Produktin Vendor (BPV) është gati 12%. Prodhimet e bujqësisë përbëjnë gati 16% të eksporteve të përgjithshme dhe sektori i bujqësisë siguron rreth 25% të punësimit të përgjithshëm.²

Rajoni i Prishtinës³ në të cilin bën pjesë edhe Komuna e Fushë Kosovës, përfshin një sipërfaqe të tokës bujqësore prej 65,265 ha apo 25.3% e sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore në Kosovë. Numri i ekonomive bujqësore (ekonomitë familjare bujqësore dhe subjektet juridike bujqësore) në këtë rajon është 31,966 që përbën 24% të numrit të ekonomive bujqësore në tërë vendin.⁴ Në bazë të këtyre të dhënave, Rajoni i Prishtinës është një ndër tri rajonet me sipërfaqe më të madhe të tokës bujqësore si dhe me numrin më të madh të ekonomive bujqësore në Kosovë.

Auditimi është fokusuar në dhënien e granteve nga Komuna e Fushë Kosovës për vitin 2014, kjo për shkak se në këtë vit komuna nuk ka aplikuar fare skema të subvencionimit të fermerëve. Grantet janë projekte investuese që realizohen me bashkëfinancim me përfituesit. Në Komunën e Fushë Kosovës për vitin 2014 vlera totale e projekteve të realizuara në sektorin e bujqësisë (grante dhe projekte tjera) ishte 277,407€.

Në bazë të analizave para studimore⁵ që kemi kryer komunat ende nuk kanë zhvilluar praktikat e mira në administrimin e subvencioneve dhe granteve. Analizat tregojnë për paqartësi rreth objektivave të planifikuara, monitorimit dhe matjes së efekteve të arritura përmes subvencioneve dhe granteve. Nëse vendimet për mbështetjen e sektorit të bujqësisë do të ishin vendime të mbështetura në strategji zhvillimore, të ishin planifikuar dhe implementuar në mënyrë efektive, atëherë ndikimi në këtë sektor do të ishte më i madh.

Andaj objektivë e auditimit është që të vlerësojmë rezultatet e arritura nga Komuna e Fushë Kosovës përmes dhënies së granteve në bujqësi. Për më tepër synimi ynë është që të japim sugjerime për përmirësimin e procesit të menaxhimit dhe implementimit të granteve.

² Përgjigjet në Pyetëtorin e Studimit të Fizibilitetit. Qershor 2012

³ Rajoni i Prishtinës përfshin 8 komuna: Glllogoc, Fushë Kosovë, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Graçanicë. Të dhënat janë paraqitur në bazë të rajonit për shkak se ende nuk ka të dhëna të ndara në mënyrë specifike për secilën nga komunat.

⁴ Rezultatet paraprake të Regjistrimit të Bujqësisë 2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Këto të dhëna nuk mund të konsiderohen si përfundimtare pasi që rezultatet finale të regjistrimit nuk ishin të gatshme në fazën gjatë së cilës është kryer auditimi.

⁵ Parastudimi ka përfshirë: Intervista me zyrtarë komunal të DPZHR, fokus grupe me përfaqësues nga niveli qendrorë dhe lokal si dhe analizë e të dhënave që kemi pranuar nga komunat.

1.1 Pyetjet e Auditimit

Ky auditim i përgjigjet pyetjes kryesore: **Deri në çfarë mase Komuna e Fushë Kosovës ka arritur rezultatet e planifikuara të shpërndarjes së granteve?**

Më tutje pyetja kryesore është zbërthyer në këto nën pyetje:

Pyetja e auditimit 1: A janë grantet pjesë integrale e objektivave strategjike për zhvillimin e bujqësisë?

Pyetja e auditimit 2: Si e ka menaxhuar Komuna e Fushë Kosovës procesin e dhënies së granteve për bujqësi?

Pyetja e auditimit 3: Cilat janë rezultatet e procesit të dhënies së granteve për bujqësi?

1.2 Kriteret e Auditimit

Për të vlerësuar rezultatet e shpërndarjes së granteve kemi vendosur tri nivele të kriterëve:

- Kriteret që kanë të bëjë me përshtatshmërinë e objektivave të vendosura (SMART) ;
- Kriteret mbi mekanizmat për menaxhim të granteve; dhe
- Kriteret për vlerësim të rezultateve dhe veprimet e ndërmarra.

1.3 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Realizimin e objektivave zhvillimore në sektorin e bujqësisë Fushë Kosova, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (DBZHR) synon t'i arrijë përmes mbështetjes financiare nga pagesat direkte (subvencioneve), projekteve investuese (granteve), si dhe përkrahjen profesionale të fermerëve (përmes trajnimeve, shërbimeve këshillimore, dhe seminareve). Fokusi i këtij auditimi është në mbështetjen financiare përmes granteve që ka realizuar DBZHR gjatë vitit 2014.

Auditimi fokusohet në: a) vendosjen e objektivave strategjike dhe operative të zhvillimit të bujqësisë b) menaxhimin e granteve c) në matjen dhe raportimin e rezultateve të arritura.

Për të vlerësuar nëse grantet janë pjesë integrale e objektivave strategjike të zhvillimit të bujqësisë janë analizuar:

- ✓ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2011-2014 (pjesa që ndërlidhet me sektorin e bujqësisë);
- ✓ Plani i punës 2014 i DBZHR;

Për të vlerësuar procesin e menaxhimit të granteve janë analizuar katër projekte të vitit 2014:

1. Mbështetja e fermerëve me gjedhe qumështore;
2. Mbështetja e fermerëve me pula vojse;
3. Ngritja e serave për kultivimin e perimeve; dhe
4. Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor.

Te këto katër projekte ne kemi analizuar këto dokumentet relevante dhe kemi realizuar intervista:

- ✓ Shpalljet publike për katër projektet të lartpërmendura;
- ✓ Kemi intervistuar personin përgjegjës të DBZHR; dhe
- ✓ Janë intervistuar dhe vizituar në teren njëmbëdhjetë fermerë përfitues.

Ndërsa për vlerësimin e rezultateve të arritura, janë krahasuar objektivat e vendosura në Planin Vjetor 2014 të DBZHR me projektet e realizuara gjatë vitit nga ky departament.

2 Përshkrimi i procesit të granteve në Fushë Kosovë

Grantet janë përkrahje financiare për projekte investive me bashkëfinancim. Pjesëmarrja mund të jetë në përqindje varësisht nga qëllimi dhe sasia e mjeteve në dispozicion. Financimi i projekteve në formë granti bëhet nga buxhetet komunale me participim të donatorëve potencialë ose me participim të fermerëve.

Administrata komunale është e organizuar në drejtori të cilat janë njësi organizative që raportojnë direkt te kryetari i komunës. DBZHR është përgjegjës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e bujqësisë duke përfshirë planifikimin e buxhetit, hartimin e planeve vjetore të punës, vendosjen e kriterëve për grante komunale, bashkëpunimin me donatorë, implementimin dhe montorimin e programeve dhe çështje të tjera që ndërlidhen me zhvillimin rural.

Fushë Kosova ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2011-2014, i cili dokument trajton çështjet zhvillimore komunale në sektorë të ndryshëm. Në kuadër të këtij plani janë vendosur objektivat që ndërlidhen me zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

DBZHR harton planet operative vjetore në të cilat përcaktohen objektivat dhe projektet konkrete që duhet të realizohen për të arritur synimet strategjike të zhvillimit të bujqësisë.

Gjatë vitit 2014 vlera e përgjithshme e projekteve të realizuara nga DBZHR në sektorin e bujqësisë ishte 277,407 €. Përveç kësaj Fushë Kosova ka bashkë financuar një projekt për “Punësim përmes avancimit të mikro-ndërmarrjeve rurale”, i cili projekt është administruar nga donatori.⁶ Gjatë viti 2014 Fushë Kosova ka kontribuar në këtë projekt në shumën prej 55,000€ ndërsa donatori 24,962€.

Në Tabelën 1 po paraqesim të dhënat financiare për projektet e planifikuara dhe ato të realizuara nga DBZHR për vitin 2014.

⁶ Donatori, United Nations Development Programme, marr[veshja e “Paktit territorial të punësimit”

Tabela 1: Të dhënat financiare të projekteve të DBZHR për vitin 2014

Nr.	Përshkrimi i projektit	Burimi i fondit ⁷	Lloji i shpenzimit	Shuma e planifikuar (€)	Vlera e realizuar (€)
1	Rritja e kapacitetit të serave	21	Grant	50,000	69,978
2	Furnizim i fermerëve me lopë qumështore	21	Grant	70,000	68,960
3	Furnizim i fermerëve me mekanizëm bujqësor	21	Grant	30,000	21,640
4	Furnizim i fermerëve me pula vojse	21	Grant	20,000	16,884
5	Ngritjen e sipërfaqeve të reja me pemë	21	Grant	20,000	14,362
6	Furnizim i fermerëve makina mjelëse	21	Grant	10,000	10,737
7	Vaksinimin e kafshëve dhe shpezëve	21	Grant	10,000	9,900
8	Furnizim i fermerëve me bletë	21	Grant	10,000	-
9	Furnizim i fermerëve me foli plastike	21	Grant	6,000	5,400
10	Mbështetje për biznese të reja	21	Grant	30,000	10,000
11	Pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura ⁸	21	/	10,000	9,968
12	Pastrimi sanitar i pyjeve	21	/	10,000	9,964
13	Deratizimi, dezinfektim dhe dezinspektimi	21	/	20,000	19,877
14	Kastrimi i qeneve endacak	21	/	10,000	9,738
	Totali			306,000 €	277,407 €

⁷ Burimi i fondit sipas planit kontabël 2014; kodi 21 paraqet te hyrat vetanake komunale

⁸ Projekti me numër rendor 11, 12, 13 dhe 14 nuk janë grante të dhëna për fermerë por projektet të tjera të bujqësisë.

3 Të gjeturat e auditimit

3.1 A janë grantet pjesë integrale e objektivave strategjike për zhvillimin e bujqësisë?

3.1.1 A ka Fushë Kosova objektiva të qarta që synon të arrijë përmes dhënies së granteve?

Komuna duhet të ketë objektiva të hartuara në mënyrë specifike, ashtu që të jetë e qartë çfarë synohet të arrihet. Është e paraparë që një objektivë specifike ka gjasë të jetë më e arritshme dhe e matshme sesa një objektivë e përgjithshme.

Plani operativ i Fushë Kosovës për bujqësi për vitin 2014, shpalos këto objektiva:

1. *Rritja e prodhimit të bimëve;*
2. *Rritja e prodhimit të blegtorale;*
3. *Rritja e prodhimit të shpezërisë;*
4. *Rritja e prodhimit të pemëtarisë;*
5. *Rritja e prodhimit të bletare;*
6. *Rritja e prodhimit të bimëve mjekësore;*
7. *Rregullimi i sistemit të ujitjes;*
8. *Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhvoshura; dhe*
9. *Pastrimi sanitar i pyjeve.*

Objektivat e vendosura në planin operativ vjetor 2014 janë të përkufizuar në formë të përgjithësuar (nuk janë specifike). Si të tilla këto objektiva janë më tepër strategjike se sa operative. Nuk është e qartë çfarë do të përmbushet në terme sasiorë, arsyt specifike të objektivës (përfitimet), kush do të jetë i përfshirë në implementim të objektivës dhe mungon identifikimi i kërkesave dhe kufizimeve.

3.1.2 Objektivat e vendosura a janë në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit të bujqësisë ?

Vendosja e objektiva operative në harmoni me prioritetet strategjike është kritike për suksesin afatgjatë të arritjes së objektivave zhvillimore. Planet strategjike duhet të shërbejnë si një kornizë për planifikim në nivel më të ulët (taktik dhe operacional) duke i mbështetur ato plane dhe duke i kthyer ato në plane specifike të nevojshme për zbatimin e planit strategjik të komunës.

Fushë Kosova ka vendosur objektivat afatgjata (strategjike) zhvillimore në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2011-2014. Në këtë dokument janë të listuara këto objektiva/prioritete të zhvillimit të bujqësisë:

1. *Rritja e fondit të bagëtisë për 20%;*
2. *Zhvillimi i prodhimtarisë bletare për 10%; dhe*
3. *Zhvillimin e prodhimtarisë së pemëtarisë.*

Objektivat e detajuara të planit vjetor të punës janë të paraqitura në nën kapitullin 3.1.1

Ne kemi konstatuar se nuk ekziston një ndërlidhje e qartë midis objektivave ose prioritetëve të prezantuara në planin strategjik dhe atyre në planin operativ vjetor. Gjashtë nga nëntë objektivat e planit operativ vjetor (Objektiva 1, 3, 6, 7, 8 dhe 9) nuk janë të ndërlidhura qartë me objektivat ose prioritet e prezantuara në planin strategjik. Kjo shmangie e vënë në dyshim zbatimin e planit strategjik, gjegjësisht arritjen e objektivave afatgjata të zhvillimit të bujqësisë.

3.1.3 A janë objektivat reale dhe të matshme?

Objektivat janë reale atëherë kur me saktësi adresojnë qëllimin e synuar duke përfshirë edhe hapat programorë që do të zbatohen brenda një kornize të caktuar kohore dhe specifikojnë resurset tjera të nevojshme për të përmbushur objektiven në fjalë. Gjithashtu objektivat duhet të reflektojnë një pikë reference për ndryshimet e synuara të cilat mund të maten në mënyrë të qartë.

Definimi i përgjithësuar i objektivave⁹ (jo specifik në terme sasimore) e pamundëson vlerësimin nëse objektivat janë reale apo optimiste, kjo për shkak se nuk është i qartë rezultati (qëllimi/efekti) që synohet të arrihet. Përveç kësaj, për arritjen e objektivave të vendosura në planin operativ vjetor nuk janë përcaktuar hapat programorë që do të zbatohen dhe definimi i resurseve të nevojshme për të realizuar hapat specifik. Në mungesë të këtyre elementeve po ashtu pamundësohet vlerësimi nëse objektiva është reale apo optimiste.

⁹ Objektivat e detajuara të planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor strategjik janë të paraqitura në nën kapitullin 3.1.1 dhe 3.1.2

Definimi i përgjithësuar i objektivave rezulton edhe me mungesë të kriterëve konkrete për matjen e progresit drejt arritjes së rezultatit të synuar. Është e pamundur të vlerësohet nëse objektiva është arritur nëse ato nuk janë të matshme në terme sasiore.

3.1.4 A janë objektivat të arritshme dhe të përkufizuara në aspektin kohor?

Pasi që komuna të ketë vendosur objektivat, duhet të identifikojë mënyrat se si ti realizojë ato. Kjo bëhet duke planifikuar hapat e duhur drejt arritjes së objektivës, duke vlerësuar kapacitet e resurseve të nevojshme dhe duke krijuar një kornizë kohore që mundëson për të kryer hapat e planifikuar.

Në planin operativ të Fushë Kosovës për bujqësi mungon planifikimi i hapave në mënyrë specifike, përcaktimi i komponentëve teknikë dhe organizativë, krijimi i kornizës kohore dhe identifikimi i resurseve të tjera që mundësojnë arritjen e objektivës. Fushë Kosova ka planifikuar disa aktivitete/projekte (Tabela 1) duke caktuar shumën financiare dhe datën (muajin) e fillimit dhe mbarimit të projektit, megjithatë këto aktivitete nuk janë qartë të ndërlidhura me objektivat e paracaktuara. Dy nga nëntë objektivat e parashtruara (Objektiva 6 dhe 7) nuk janë zbërthyer në projekte konkrete që mundësojnë arritjen e tyre. Gjithashtu tri nga katërmbëdhjetë projektet e planifikuara (Projekti 4, 6 dhe 10) nuk korrespondojnë me objektivat e parashtruara.

3.1.5 A janë caktuar indikatorët kyç të performancës?

Për objektivat e parashtruara komuna duhet të sigurojë bazën për monitorim dhe vlerësim të rezultateve e cila bëhet duke identifikuar indikatorët kyç të performancës.

Fushë Kosova nuk ka identifikuar indikatorët kyç të performancës për të vlerësuar rezultatet e arritura (efektet e planifikuara) kundrejt objektivave të vendosura.

3.2 Si e ka menaxhuar Fushë Kosova procesin e dhënies së granteve për bujqësi?

3.2.1 Si është informuar grupi i synuar i fermerëve?

Komuna duhet të definojnë në mënyrë të qartë grupin e synuar të fermerëve që do të jenë përfitues potencialë duke aplikuar kritere konkurruese, si dhe duhet të përdorë mekanizma efektivë të informimit të fermerëve.

Fushë Kosova ka aplikuar disa teknika për të njoftuar grupin e synuar të fermerëve duke shpallur thirrjet publike në faqet zyrtare në internet, përmes shpalljes publike ne objektin e Komunës, dhe njoftimet media lokale. Megjithatë shtatë nga njëmbëdhjetë fermerët e intervistuar janë deklaruar se janë informuar nga fermerë të tjerë. Kjo nënkupton që teknikat e informimit nuk e kanë arritur të gjithë grupin e synuar të fermerëve. Informatat/kriteret e vendosura në konkurs janë shumë të përgjithshme dhe të arritshme për shumicën e fermerëve. Në vazhdim po paraqesim disa nga kriteret e përdorura për katër konkurset që ne kemi analizuar:

- Të jetë banorë i Komunës së Fushë Kosovës;
- Të ketë paguar tatimin në pronë;
- Të ketë stallë adekuate për vendosjen e kafshëve;
- Të ketë grumbulluar ushqime të mjaftueshme për kafshë;
- Të jetë i përkushtuar në lëmine e bujqësisë;
- Të ketë tokë të mjaftueshme për kultivimin perimeve;
- Të ketë burmim të ujit të përshtatshëm për ujitje të perimeve; dhe
- Të nënshkruaj kontratë me DBZHR.

Këto kritere nuk e bëjnë të qartë grupin e synuar të fermerëve që do të jenë përfitues. Në këtë situatë numri i aplikantëve që i përmbushin kriteret mund të jetë shumë i madh ndërkaq numri i përfituesve është i kufizuar me konkurs, si rezultat fermerët mund të largohen nga lista edhe pse përmbushin kriteret.

3.2.2 A bëhen inspektime në teren si dhe a raportohen rezultatet?

Monitorimi nga komuna duhet të sigurojë një grumbullim sistematik dhe periodikisht të përsëritur të informacionit duke filluar që në fazën e planifikimit të projekteve. Kjo do të mundësonte që rezultatet, proceset dhe përvojat të dokumentohen dhe të përdorën si bazë për vendimmarrje dhe si proces i të mësuarit.

Fushe Kosova ende nuk ka vendosur një sistem të qartë të monitorimit të projekteve të ndërmarra. Ekziston një plan monitorimi që ka shpалosur vetëm muajt në të cilët do të bëhet monitorimi i projekteve. Në tri nga katër projektet që ne kemi analizuar, ishin të planifikuar tri monitorime/vizita në teren. Dy nga këto vizita ishin planifikuar të realizohen ende pa filluar të realizohet projekti. Ndërsa në një projekt tjetër, të gjitha vizitat në teren janë planifikuar ende pa filluar të realizohet projekti.

Një nga njëmbëdhjetë fermerët e intervistuar kanë deklaruar se nuk janë inspektuar asnjëherë nga komuna, ndërsa të tjerët kanë deklaruar se janë vizituar një herë ose dy pas përfitimit të grantit. Megjithatë edhe në ato projekte ku ka pasur inspektime, nuk janë përgatitur raporte që paraqesin gjendjen faktike në teren. DBZHR ka hartuar vetëm raporte përmbledhëse për projektet që ka realizuar. Këto raporte nuk përmbajnë informata të besueshme relevante dhe në kohë. Në disa raste datat e raporteve të monitorimit janë më të hershme se datat e kontratave me fermerë, që do të thotë monitorimet janë kryer para se projekti të jetë realizuar. Objektivat e projekteve si dhe kritere rreth të cilave është bërë monitorimi (indikatorët e performancës) janë të pa qarta dhe në disa raste jo relevante sepse nuk korrespondojnë me njëra tjetrën. Në vazhdim po paraqesim objektivat dhe kriteret e monitorimit në dy nga katër projektet që ne kemi analizuar.

- Projektit “Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor” kishte këto objektiva: 1.Lehtësimi i punës në ferma; 2.Përmirësimi i kualitetit të kulturave bujqësore dhe perimokultura; 3.Rritja e kapaciteteve të perimeve në ferma; 4.Preventiva ndaj sëmundjeve dhe insekteve parazitë.

Raporti i monitorimit për këtë projekt shpалos këto kritere të monitorimit/indikatorë të performancës : A ka ndikuar projekti në rritjen e sasisë dhe kualitetit të kulturave me rritjen e mekanizmit bujqësor; Si është gjendja e mekanizmit bujqësor sot dhe a është shfrytëzuar si duhet; Sa është rritur sasia e kulturave në ferma; Si është cilësia e kulturave; Gjendja shëndetësore e kulturave ; Kualiteti i ushqimit; dhe Higjiena në ferma.

- Projektit “Ngritja e serave për kultivimin e perimeve” kishte këto objektiva: 1.Lehtësimi i punës në sera; 2.Përmirësimi i kualitetit të perimeve; 3.Rritja e kapaciteteve të perimeve në sera; 4.Preventiva ndaj sëmundjeve.

Raporti i monitorimit për këtë projekt shpалos këto kritere të monitorimit/indikatorë të performancës :A ka ndikuar projekti i serave në rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve; Si është gjendja e serave sot dhe a është shfrytëzuar si duhet; Sa është rritur sasia e prodhimeve në ferma; Si është cilësia e prodhimeve; Si është kondicioni trupor i fidanëve ; Gjendja shëndetësore e fidanëve; Kualiteti i ushqimit; Higjiena në sera.

Gjatë vizitës në teren ekipi i auditimit ka konstatuar dy raste që granti i dhënë nga komuna ishte tjetërsuar (një serë për kultivim të perimeve dhe një lopë qumështore), dhe për këtë komuna nuk ishte në dijeni. Gjendja e tillë shfaqë rrezikun që të ketë edhe raste tjera të tilla.

3.2.3 A janë përgatitur raporte të vlerësimit për rezultatet e arritura kundrejt atyre të planifikuara?

Monitorimi nga komuna duhet të shërbejë si pjesë integrale e vlerësimit duke siguruar bazën e analizave vlerësuese për të ndihmuar nxjerrjen e konkluzioneve rreth aspekteve kryesore të projektit: relevancës, efikasitetit, efektivitetit dhe ndikimit. Vlerësimet e tilla ndihmojnë vendimet strategjike duke përmirësuar kështu projektet në të ardhmen.

Komuna nuk ka bërë analiza të vlerësimit dhe interpretimit të rezultateve të projekteve, efekteve të prodhuara dhe ndikimit të përgjithshëm të projektit/programit.

Pasi që komuna nuk ka përgatitur raporte të monitorimit (nuk janë raportuar të dhënat nga vizitat në teren) , ne nuk kemi mundur të vlerësojmë se si komuna ka vepruar me të dhënat e mbledhura nga monitorimi.

3.3 Cilat janë rezultatet e procesit të dhënies së granteve për bujqësi?

3.3.1 Në çfarë mase Fushë Kosova ka arritur të përmbushë objektivat e synuara?

Objektivat e vendosura nga Komuna duhet të jenë të qarta (SMART), duke qartësuar po ashtu efektet e dëshiruara (rezultatet e pritura) nga arritja e objektivave të parashtruara. Rezultatet në teren duhet të monitorohen, të raportohen dhe pastaj të vlerësohen kundrejt indikatorëve të vendosur të performancës për të vlerësuar nëse janë arritur efektet e dëshiruara.

Komuna ka vazhduar të mbështesë zhvillimin e sektorit të bujqësisë, megjithatë kjo është bërë pa pasur vlerësime dhe strategjinë e duhur duke u bazuar në vendime të rastit. Përkufizimi i përgjithshëm i objektivave (jo sipas kriterëve SMART) si dhe mungesa e raporteve të vlerësimit nuk e mundësojë vlerësimin nëse komuna ka arritur rezultatet e dëshiruara. Gjendja e tillë flet për shpenzime jo efektive dhe jo efikase të parasë publike.

3.3.2 Nëse nuk janë arritur objektivat, cilat janë shkaqet kryesore për dështimin e tyre?

Komuna duhet të vendosë një proces përmes të cilit në mënyrë sistematike bëhet vlerësimi i performancës aktuale krahasuar me performancën e pritshme, në ç’rast identifikohen shmangiet (dështimet) në arritjen e objektivave. Përveç vlerësimit sistematik duhet bërë edhe vlerësime përfundimtare për të vlerësuar nëse projektet kanë arritur efektet e pritura. Këto vlerësime (analiza) duhet të nxjerrin shkaqet e dështimit, në rastet kur arritja e objektivave ka dështuar apo nuk është e kënaqshme.

Komuna nuk ka bërë vlerësime për të krahasuar rezultatet arritura kundrejt atyre të planifikuara, rrjedhimisht nuk janë identifikuar shkaqet e dështimit (nëse do të kishte të tilla).

3.3.3 Çfarë veprimesh ka ndërmarrë Fushë Kosova nëse rezultatet e arritura nuk janë përputhur me ato të planifikuara?

Pasi që Komuna të ketë vlerësuar në mënyrë sistematike rezultatet kundrejt planifikimit (vlerësim kundrejt indikatorëve të performancës), identifikon shmangiet (variancat, dështimet), Komuna duhet të përgatitë veprime konkrete (plane veprimi) për të sjellë performancën në nivelin e duhur. Në rastin e vlerësimit përfundimtar komuna duhet të nxjerrë të gjetura dhe konkluzione (mësime) që do ta ndihmojnë vendimmarrjen në të ardhmen.

Fushë Kosova nuk ka bërë vlerësime për të krahasuar rezultatet arritura kundrejt atyre të planifikuara. Rrjedhimisht nuk janë identifikuar shmangiet (dështimet) dhe nuk janë ndërmarrë veprime konkrete për ti përmirësuar ato.

4 Konkluzionet

Kriteret e auditimit të vendosura për çdo pyetje audituese paraqesin gjendjen se si duhej të ishte. Ne konkludojmë që Fushë Kosova nuk ka performuar në përputhje të plotë me pritjet/kriteret e vendosura.

Ne kemi vënë re disa aktivitete të procesit të shpërndarjes së granteve kanë shkuar mirë. Megjithatë ky proces është përcjellë me mangësi të theksuara të cilat duhet adresuar për të arritur efikasitetin dhe efektivitetin në shpenzimin e parasë publike.

- Objektivat e vendosura në planin operativ 2014 nuk janë mjaft qartë të definuara dhe nuk kanë ndërlidhje të mjaftueshme me planet strategjike. Rezultatet përfundimtare të projekteve nuk janë parashikuar, mungon konsistenca në mes projekteve të planifikuara dhe objektivave të parashtruara. Rreth qartësisht të objektivave mungojnë: përcaktimi i komponentëve teknike dhe organizative, identifikimi i rezultateve të pritura dhe nuk është siguruar baza për monitorim dhe vlerësim të rezultateve.
- Janë vërejtur mangësi edhe në procesin e menaxhimit të granteve. Informimi i fermerëve nuk ishte mjaft cilësor, kjo për shkak se kriteret e vendosura në konkurse nuk specifikojnë qartë grupin e synuar të fermerëve që do jenë përfitues potencial dhe metodat e informimit nuk kanë dhënë rezultate të kënaqshme.
- Sistemi i monitorimit të granteve nuk ishte funksional ashtu siç pritej. Edhe pse behën inspektime të rastësishme (jo të strukturuar) në teren, raportimit i rezultateve nuk është i cilësisë së duhur. Kjo ka ndikuar që mekanizmi për kontrollin e progresit kundrejt planeve dhe vlerësimi i efekteve të mos funksionojë. Rrjedhimisht efektet e projekteve nuk janë plotësisht të qarta.
- Në mungesë të raporteve cilësore të monitorimit dhe në mungesë të raporteve të vlerësimit, nuk ka informacion rreth rezultateve të arritura përmes granteve të dhëna. Kjo gjendje mund të shpije deri tek shpenzimi i parasë në mënyrë jo efikase dhe jo efektive.

5 Rekomandimet

Për arritjen e rezultateve zhvillimore në sektorin e bujqësisë Fushë Kosova duhet të vendosë një kornizë të qartë të objektivave. Pastaj duhet të sigurojë që objektivat janë zbërthyer në aktivitete konkrete, të sigurojë që këto aktivitete janë menaxhuar si duhet, si dhe të aplikojë një sistem ku rezultatet maten dhe raportohen.

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës të siguroi që :

- Vendosja e objektivave në planet operative të bëhet sipas kriterëve SMART dhe në përputhje me objektivat strategjike.
- Të aplikojë metoda më efektive të informimit të grupit të synuar të fermerëve dhe në konkurse për grante të vendosen kriterë specifike që fokusohen vetëm në grupin e synuar të fermerëve.
- Të dizajnohet dhe vendoset një sistem përmes së cilit do të monitorohen, raportohen dhe vlerësohen rezultatet nga grantet, dhe
- Të hartojë informata të besueshme , relevante dhe në kohë lidhur me progresin drejt arritjes së objektivave. Kjo do të forconte llogaridhënien e brendshme dhe të jashtme për burimet e përdorura dhe për rezultatet e arritura.

Shtojca I - Përkufizimi i kriterëve SMART

- ✓ **Specifike** - Në procesin e definimit të objektivave të shmangen deklaratimet e përgjithshme duke specifikuar në mënyrë të qartë çfarë synohet të arrihet;
- ✓ **Të matshme** - Të vendosen kriteret konkrete(indikatorët e performancës) për matjen e progresit drejt arritjes së objektivave të parashtruara;
- ✓ **Të arritshme** -Të bëhet një vlerësim i kapaciteteve të burimeve në dispozicion për tu siguruar që objektivat janë të arritshme;
- ✓ **Reale** - Për të qenë reale komuna duhet të vendosë objektiva të cilat është e aftë ti arrijë ato; dhe
- ✓ **Të definuara në kohë**- Objektivat duhet të jenë të përkufizuara brenda një kornize kohore